



Pranimi / Dorezuar Prijmjen / Predato Received / Delivery	31.01.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Org. / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/8HCK	418/2022		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1219/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1219/2021 të datës 24.12.2021 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Ministrisë së Ekonomisë, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.01.2022, mori këtë:

### V E N D I M

**Përfundon Procedimi Administrativ** i iniciuar me ankesën me numër A.nr.1219/2021 e datës 24.12.2021 të parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Ekonomisë, përmes postës më datë 22.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar më datë 24.12.2021 me numër të ankesës A.nr.1219/2021 dhe Nr. Prot:6331/2021, kundër organit të punësimit Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik me pretendimin ankimor për ngritjen e koeficientit të pagës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Ministrinë e Ekonomisë. Më datë 10.01.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Ekonomisë, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.1219/2021 me Nr.



Prot:66331/2021 të datës 24.12.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit të datës 01.04.2012; Përgjigjen e datës 23.11.2021 të Drejtorit të Financave; Kërkesën për harmonizimin e koeficientit të datës 17.11.2021; Kërkesën e datës 09.03.2020; Përgjigjen e datës 23.06.2020; Kërkesën e datës 05.08.2020; Akt emërimit të datës 03.03.2014; Akt emërimit të datës 07.08.2012; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit të datës 12.02.2015; Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër Cp.Nr.851/17; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.12.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 10.01.2022; E-mailin e datës 30.06.2021 dërguar nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ me korrespondencën e bashkangjitur prej pesë (5) faqesh lidhur me deklarin e statusit zyrtar të ankuesit; E-mailin e datës 02.07.2021 dërguar nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ me korrespondencën e bashkangjitur prej tre (3) faqesh lidhur me deklarin e statusit zyrtar per pozitën e nëpunësve; Autorizimin e datës 22.05.2013; Kërkesën për aprovimin e fillimit të rekrutimit të datës 16.05.2013; Vendimin e Këshillit A.nr.300/2020 të datës 17.11.2020; Shkresën e datës 04.02.2005.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar ankesën e ankuesit dhe të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për objektin e njëjtë të ankesës të ankuesit, me datë 17.11.2020 ka nxjerr Vendimin me numër A.nr.300/200, me të cilin e ka shpallur veten jo kompetent për ankesën e ankuesit \_\_\_\_\_ të datës 13.10.2020, pasi që i njëjti nuk e ka statusin e “Nëpunësit Civil” në Shërbimin Civil, kështu që Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën ankuesit të datës 24.12.2021 është bërë i pamundur siç përcaktohet me dispozitat e nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike”, pasi që për rastin e ankuesit është vendosur njëherë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.1219/2021

**Flakron GASHI**



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë;
- Udhëheqësit së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

